

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"EAGLE DEVELOPMENTS GROUP" SHPK**

**KREU I**

**Dispozita te Pergjithshme**

Sot, në datën 14 / 06 /2022 (dy mijë e njetë e një) personat e mëposhtem:

- **Z. Ardian BEJLERAJ**, atesia Rauf, amesia Violeta, i datelindjes 03.11.1969, lindur ne Fier dhe banues ne Patos, Fier, shtetas Shqiptar, madhor, me zotesine e plote per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit nr.personal G91103141I;
- **Znj. Dimitra GELAGOTA**, atësia Fotis, e datëlindjes 17.04.1973, lindur ne Larisa - Greqi dhe banuese ne Greqi, shtetase Greke, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit Grek me nr. AK 307753 leshuar nga Komisariati i Policise se Thessaloniki me date 13.02.2012;

ne cilesine e "Ortakeve Themelues", me vullnet te lire te plote e te singerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, Kodin Civil ne fuqi, ligjin Nr. 9901 date 04.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", te ndryshuar vendosen te themelojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin **"EAGLE DEVELOPMENTS GROUP" SHPK**.

**KREU II**

**Ortakët, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra Qendrore**

**Neni 1**

**Emri dhe Ortaket**

- 1.1 Shoqeria eshte e organizuar dhe funksionon sipas formes "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" dhe mban emrin **"EAGLE DEVELOPMENTS GROUP" SHPK**.
- 1.2 Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri.

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria " **EAGLE DEVELOPMENTS GROUP" SHPK** do te kete objekt veprimtarie: Aktivitet konsulence, studimesh dhe kerkime tregu, aktivite promovionale per nisma tregtare, industriale dhe zhvillimi te aktiviteve; Berjen e kerkimeve te tregut ne lidhje me nisma prodhuese per pasuri dhe/ose sherbime; Furnizimin e sherbimeve te business information; Monitorimi dhe ruajtja e nismave sipermarrese, Dhenie sherbimesh, edhe ne kuader te te treteve, me qellim promovimin e zhvillimit te racionalizimit te administrimit te ndermarrjeve; Dhenie e sherbimeve ndermjetesimit, te komisionit, brokerimit; Dhenie e sherbimeve administrative, teknike, tregtare dhe financiare: Asistencen tekniko - ekonomike per ndermarrjet per perftimin e financimeve dhe/ose kontributeve qe te sherbejne per marrjen e lehtesimeve ne nivel kombetar ose te komunitetit nderkombetar; Dhenie sherbimesh dhe realizimet e studimeve per te optimizuar e administrimit te ndermanjeve, enteve dhe konsorciumeve, kooperativave, nepermjet nderhyrjeve te organizimit, ristrukturimit, kontrollit te administrimit, planifikimit financiar, kontrollit sasior dhe cilesor te prodhimit, dhe te kostove perkatese, aplikimin e metodologjive te veta dhe te te treteve, koordinimin teknik, logjistik, tregtar, financiar, dhe te promovimit te ndermanjeve, analizen e risqeve per 1 2 ndermarrjet (risk management). Sherbime informacioni, konsulence dhe

asistence per ndermarrjet per gjetjen dhe perdorimin me te mire te burimeve financiare, perfshire nje sherbim grumbullimi dhe shperndarje te informacioneve te pershtatshme per te lehtesuar aksesin per kredi; Aktivitet konsulence te specializuar per te korporuar financa dhe suport ne zgjedhjet strategjike te financimit dhe te ristrukturimit; Te jape konsulence dhe asistence ne operacionet e finances se jashtezakonshme. Te jape konsulence dhe asistence ne operacionet e blerjes, shitjes dhe vleresimeve te ndermarrjeve. Te pergatise studime fizibiliteti, te percaktoje nevojat financiare dhe te gjeje mjetet e mbulimit edhe te lehtesuar, analize te kthimeve ekonomike, analiza dhe vleresime hipoteke, markash dhe patentash, gjetjen, konsolidimin, transferimin e eksperiences se ndermarrjes, kerkim, promovim te joint venture. Te promovoj dhe te mbeshtese operacione te project financing. Studim, kerkim, furnizim teknologjish te pershtatshme per realizimin, impiante per fabrika, industrial, fabrika dhe njesi prodhuese me celesa ne dore, si ne Shqiperi ashtu edhe jashte shtetit;

### Neni 3

#### Kohëzgjatja

- 3.1 Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje afat te pakufizuar, me perjashtim te rastit kur Asambleja e Ortakeve, sipas kuorumit perkates vendos ndryshe.
- 3.2 Shoqeria "EAGLE DEVELOPMENTS GROUP" SHPK gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin tregtar te QKB-se.

### Neni 4

#### Zyra Qendrore

- 4.1 Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Tirane, Rruga "Arkitekt Sinani" Ap. Nr3, pasuria Nr. 7/954/ND+2-3 Volumi 38, Faqe 205.**
- 4.2 Gjate veprimtarise se saj, shoqeria ka te drejte te krijojte dhe hape dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi edhe ne qytete te tjera, brenda dhe/ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin e kerkuar ne fuqi sipas juridiksionit te vendit perkates.

### KREU III

#### Neni 5

#### Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

- 5.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është **100.000 Lek** (njqindmije lek), i barabarte me 2 (dy) kuota. Kontributet e ortakeve perbejne kapitalin e regjistruar te shoqërisë.
- 5.2 Pjesëmarrja e Ortakut në kapitalin e shoqërisë eshte ne raport me kontributin e derdhur prej tij dhe vlera nominale e kuotes te seicilit ortak, llogaritet ne raport me seicilin kontribut, e paraqitur ne menyre te permbledhur sipas grafikut te meposhtem:

Nr.	Emri i Ortakeve	Kuota	Kontributi i ortakeve ne kapital (leke)	Perqindja ne kapital
1.	<b>Z. Ardian BEJLERAJ</b>	1	50.000	50 %
2.	<b>Znj. Dimitra GELAGOTA</b>	1	50.000	50 %
<b>Totali</b>		<b>2</b>	<b>100.000</b>	<b>100 %</b>

- 5.3 Kontributet sa me siper jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht nga ana e ortakeve te shoqërisë.

### Neni 6

#### Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar




**6.1** Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakëve në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

**6.2** Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave (tre të katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh që të respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

## **KREU IV**

### **Neni 7**

#### **Kuotat dhe Kalimi i Kuotave**

**7.1** Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim ndërmjet paleve.

**7.2** Transferimi i kuotave të ortakëve të shoqërisë brenda ortakërisë apo në drejtim të personave të tjerë jashtë ortakërisë është i kushtëzuar në çdo rast nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes në favor të ortakëve ekzistues.

Ortaku, para se t'i transferojë në çdo formë kuotat e veta një ortaku ekzistues brenda shoqërisë apo një personi të tjerë jashtë saj, detyrohet të njoftojë me shkrim paraprakisht të gjithë ortakët ekzistues nëse dëshirojnë të blejnë kuotat me të njëjtat kushte ekonomike si dhe në mënyrë përpjestimore sipas kuotave që zoterojnë në kapital të shoqërisë.

Në rast se të gjithë ortakët nuk përgjigjen me shkrim brenda 20 ditëve nga njoftimi apo deklarohen se nuk dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i lirë të transferojë kuotat e tij të drejtë apo pjesërisht në drejtim të personave të tjerë jashtë ortakërisë.

Në rast se një pjesë e ortakëve ekzistues përgjigjen me shkrim brenda 20 ditëve dhe deklarohen se dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i detyruar të transferojë kuotat e tij në drejtim të tyre në mënyrë të barabartë (dmth në rast se dy ortakë shprehin dëshirën për blerjen e kuotave, ato do të shiten të dy ortakëve në mënyrë të barabartë, pra 50% secilit).

### **Neni 8**

#### **Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit**

**8.1** Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotëruar ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.

**8.2** Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotëruar i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotëruar i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotëruar i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.

**8.3** Personi që fiton të drejtë mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të

një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKB.

#### Kreu IV Asambleja e Përgjithshme

##### Neni 9

##### Kompetencat dhe Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

9.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimarrës i Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme do te vendose, por pa u kufizuar, per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:

- a. percaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime te Statutit;
- c. emerimi dhe shkarkimi i administratorit/administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga ana e administratorit/administratoreve, duke perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
- g. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
- h. zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit;
- i. pjesetimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
- j. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/administratoreve te saj;
- l. riorganizimi dhe prishja e Shoqerise;
- m. miratimi i rregullave procedurale te mbledhjeve te saj;
- n. çeshtje te tjera te parashikuara nga Ligji per Shoqerite Tregtare dhe Statuti.

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht."

- 9.2 Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet e permendura ne pikat (g) dhe (h) me siper pas shqyrtimit te dokumentacionit perkates te derguar me thirrjen e mbledhjes se asamblese se pergjithshme.
- 9.3 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratori apo ortakët e minorances sipas dispozitave te ligjit per shoqerite tregtare ne fuqi nëpërmjet një njoftimi me shkrese, me postë ose e - mail drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 (shtatë) ditë të plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga te gjithë ortakët qe zoterojne 100% te kapitalit te shoqerise.
- 9.4 Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te permbaje ne menyre te qarte daten, ditën, kohen, vendin dhe rendin e dites te mbledhjes, se bashku me dokumentacionin

perkates dhe do t'u dergohen te gjithe Ortakeve te Shoqerise te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes.

Ne rast ndryshimi te rendit te dites, do te ndiqet e njejta procedure njoftimi qe pershkruhet me siper.

## **Neni 10**

### **Kuorumi i nevojshem**

- 10.1** Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë jo me pak se 51 për qind të kapitalit të shoqerise.
- 10.2** Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë jo me pak se 51 për qind të kapitalit të shoqerise.
- 10.3** Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **Neni 11**

### **Marrja e vendimeve**

- 11.1** Asambleja e Ortakeve vendos me 3/4 të ortakëve zoterues te kapitalit te shoqerise me te drejte vote, për ceshtje te rendesishme qe kane te bejne me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.
- 11.2** Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e thjeshte te votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera te zakonshme si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve;
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 11.3** Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.  
Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.  
Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 11.4** Kryetari i mbledhjes se asamblese se pergjithshme do te jete administratori i shoqerise i cili do te drejtoje mbledhjen dhe asambleja e pergjithshme ne cdo mbledhje te saj do te emeroje me shumice te thjeshte te votave te ortakeve pjesemarres edhe nje person tjetër për të mbajtur proces-verbalin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme.
- 11.5** Çdo vendim i mbledhjes se asamblese se pergjithshme do te regjistrohet ne proces-verbal, i cili do te mbahet ne perputhje me nenin 90 te ligjit Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

## Neni 12

### Votat e Ortakëve

- 12.1** Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi.
- 12.2** Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

## Kreu V Administratori

## Neni 13

### Emërimi i Administratorit

- 13.1** Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votave të ortakëve në Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.
- 13.2** Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë **"EAGLE DEVELOPMENTS GROUP" SHPK:**  
**Z. Ardian BEJLERAJ**, atesia Rauf, amesia Violeta, i datelindjes 03.11.1969, lindur në Fier dhe banues në Patos, Fier, shtetas Shqiptar, madhor, me zotesinë e plote për të vepruar, mbajtes i Leternjoftimit nr.personal G91103141I, **per nje afat 5 vjecar, nga momenti i regjistrimit te ketij fakti prane Qendres Kombetare te Biznesit.**

## Neni 14

### Kompetencat e Administratorit

- 14.1** Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa me sipër dhe ligjit tregtar në fuqi.
- 14.2** Pa u kufizuar sa me sipër, në mënyrë të vecante, Administratori ka keto kompetenca:
- (i) do të drejtojë dhe të përfaqësojë Shoqërinë përsa i përket administrimit të zakonshëm;
  - (ii) do të nënshkruajë çdo marrëveshje në emër të Shoqërisë;
  - (iii) do të hapë llogari në emër të Shoqërisë me çdo bankë që kryen aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj,
  - (iv) do të përgatitë të gjitha planet për marrjen e financimeve, do të nënshkruajë çdo kontratë huaje apo kontratë tjetër që parashikon një borxh apo borxh të mundshëm për Shoqërinë, hipoteke, peng apo çdo marrëveshje tjetër që krijon apo mund të krijojë një barri mbi pasuritë e Shoqërisë, marrëveshje garancie, kontratë për shitjen e pasurive të paluajtshme apo të luajtshme të Shoqërisë. Të gjitha veprimet e parashikuara këtu (pika iv) do të jenë të vlefshme nëse janë të autorizuara shprehimisht me anë të një Vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë unanime;
  - (v) do të urdherojë dhe kryejë pagesa në emër të Shoqërisë – duke nënshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;
  - (vi) do të kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të Shoqërisë;

- (vii) do të përgatise dhe nënshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme;
- (viii) do të krijojë një sistem monitorimi dhe paralajmërimi njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcenojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- (ix) do të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas kërkesave të Ligjit nr. 9723, datë 3 Maj 2007 "Për Qendren Kombëtare të Biznesit";
- (x) do t'i raportojë Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
- (xii) do të marrë në punë, emerojë, shkarkojë të punësuar të Shoqërisë për çdo nivel, përfshirë edhe të punësuar me kohë të pjesshme, konsulentë, agjente, do të përcaktojë kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do të përcaktojë shpërblimin e tyre;
- (xi) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, duke pasur parasysh respektimin në çdo rast të kufizimeve të parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhëna me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sa më sipër, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

#### **Neni 15**

##### **Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit**

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
3. ndodhet ose mund të ndodhet në kushtet e pa-afesise fizike;
4. jep dorëheqje nga detyra duke njoftuar shoqërinë;
5. vdekjeje;
6. ndodhet në situata apo rrethana të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e detyrave të tij;

#### **Neni 16**

##### **Kufizimet në Veprimet e Administratorit**

- 16.1** Administratori nuk do të lidh marrëveshje për çështje në të cilin ai ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit për shoqëritë tregtare, deri në momentin kur Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë, në baze të kuorumit të kërkuar, autorizojë lidhjen e kësaj marrëveshje.
- 16.2** Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### **Kreu VI Prishja dhe njoftimet**




## Neni 17

### 17.1 Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;

b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;

c) në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;

ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të ligjit për shoqëritë tregtare;

d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;

dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;

e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

**17.2** Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

**17.3** Administratori është i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKB, me përjashtim të rastit kur prishja bëhet me vendim gjykate; në këtë rast është gjykata që i dërgon njoftimin QKB-se.

## Neni 18

### Njoftimet

**18.1** Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

**18.2** Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortakut. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

## Neni 19

### Te Ndryshme

**19.1** Cdo dokument që leshohet për dhe në emër të shoqërisë është i pavlefshëm nëse nuk mban vullnetin e saj.

**19.2** Të gjitha marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me Kodin e Punës dhe cdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe në veprim kohë pas kohë gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.

**19.3** Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.

**19.4** Në fund të cdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, të cilet i dërgohen për miratim Asamblesë së zakonshme.

**19.5** Për të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në fuqi, të azhurnuar.

## NENI 20


### Dispozita perfundimtare

- 20.1** Ky statut perben dokumentin e vetem te shoqerise qe parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarise se shoqerise. Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me nje statut te ri vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve sipas shumices se cilesuar te percaktuar me siper.
- 20.2** Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, ortaket do ti referohen legjislacionit tregtar Shqiptar ne fuqi si dhe praktikave tregtare ne vend.

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare, me permbajtje dhe vlere te njejte juridike, ne gjuhen Shqip dhe u nenshkrua nga ortaku themelues pa asnje rezerve.

### ORTAKET THEMELUES

**Z. Ardian BEJLERAJ**

*Ardian Bejleraj*  


**Znj. Dimitra GELAGOTA**

*ΔΗΜΗΤΡΑ ΓΕΛΑΓΟΤΑ*  
